

Nga shembja e një vinçi në qytetin e shenjtë, Mekë, për shkak të motit të keq, numri i të vdekurve arriti në 107, raporton Anadolu Agency (AA).

Në një deklaratë në Twitter nga Departamenti i Mbrojtjes Civile të Arabisë Saudite, thuhet se numri i të vdekurve ka arritur në 107, ndërsa numri i të plagosurve në 238.

Theksohet se në zonën ku ndodhi fatkeqësia vazhdon pastrimi dhe heqja e mbetjeve të vinçit, ndërkohë ditën e sotme Qabja nuk është hapur për besimtarët në kohën e namazit të sabahut.

Në deklaratat e mëparshme ishte thënë se në këtë tragjedi humbën jetën 65 persona dhe më pas në një tjetër deklaratë flitej për 80 persona të vdekur, ndërsa në orët e vona në një deklaratë të përditësuar u tha se numri i të vdekurve kishte arritur në 87.

Nga ana tjetër Kryetari i Çështjeve Fetare të Turqisë në një deklaratë për mediat tha se 2 besimtarë me nënshtetësi turke kanë mbetur të vrarë dhe 19 të tjerë janë plagosur.

Ndërkohë Emir i Mekës, Halid el-Fejsal ka thënë se ka urdhëruar një hetim të shpejtë të ngjarjes për gjetjen e arsyes së rënies së vinçit dhe vënien përpara drejtësisë përgjegjësit.

//

Fatkeqësi në #Mekë, arrin në 107 numri i të vdekurve, ndërsa numri i të plagosurve në 238 #AA #Mecca #Hajj2015 #Haxh #shqip <http://u.aa.com.tr/591823>

Posted by [Anadolu Agency Shqip](#) on Saturday, September 12, 2015

//

Fatkeqësi në #Mekë, arrin në 107 numri i të vdekurve, ndërsa numri i të plagosurve në 238 #AA #Mecca #Hajj2015 #Haxh #shqip <http://u.aa.com.tr/591823>

Posted by [Anadolu Agency Shqip](#) on [Saturday, September 12, 2015](#)